


RAPORT

VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË ENERGJISË NË NDËRTESA PËRMES KONCEPTIT TË VARFËRISË ENERGJETIKE



2018

Vlerësimi i performancës së energjisë në ndërtesa përmes konceptit të varfërisë energjetike



Përgatiti për botim:

Qendra mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (Qendra EDEN)

Punoi në shkrimin e materialit:

Lira Hakani
Herda Paço

Kontribuan në shkrimin e materialit:

Alba Naçi (CRCD, Vlorë)
Alminda Mema (AIC, Shkodër)
Ahmet Mehmeti (KEE, Elbasan)
Gentiana Deçolli (PMSM, Berat)
Ita Angoni (EcoAlbania, Tiranë)

Redaktoi materialin:

Ermelinda Mahmutaj

Analiza Statistike:

Dr. Eliana Ibrahim

Design

Zekri Picari

Printim

Express Print and Communication

Ky raport vlerësues është realizuar nga Qendra mjedisore EDEN në kuadër të projektit "Së bashku një sy për mjedisin!", i mundësuar në kuadër të programit "Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile në Shqipëri (SENIOR-II), i cili zbatohet nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri dhe financohet nga Qeveria Suedeze.

Përmbajtja e raportit është përgjegjësi vetëm e Qendrës mjedisore EDEN në emër të partnerëve zbatues të projektit "Së bashku një sy për mjedisin!" dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Qeverisë Suedeze dhe/apo të REC Shqipëri.

Janar 2018



PËRMBAJTJA

Hyrje.....	5
Koncepti i varfërisë energjetike	6
Baza ligjore.....	8
Metoda.....	10
Rezultate dhe Interpretime	13
• Njësi ekonomike familjare	13
• Njësi të tjera ndërtesash	23
Interferenca.....	34
Përfundime.....	36
Rekomandime.....	38
Shtojca.....	39

Vlerësimi i paraqitur, i pari i këtij lloji në Shqipëri që përdor konceptin e varfërisë energjetike ecën në të njëjtën linjë me sfidën e rëndësishme në ditët e sotme ndaj kërkesës së vazhdueshme të rritjes së konsumit të energjisë elektrike apo të formave të tjera të energjisë për të plotësuar nevojat e banorëve për përmbushjen e të gjitha aktiviteteve jetësore. Koncepti lidh në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të fortë qytetarin me mjedisin; bën të prekshme mundësitë e arta për standardin e jetesës që ofrohen përmes objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm; dhe shfaqet shumë aktual dhe i nevojshëm për realitetin shqiptar. Rrjeti i vigjilencës mjedisore "Një sy për mjedisin!" zhvillon këtë vlerësim në kuadër të projektit "Së bashku një sy për mjedisin" me mbështetje financiare të Ambasadës Suedeze në kuadër të Programit Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile në Shqipëri (SENIOR II) dhe i zbatuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit Shqipëri (REC).

Raporti vlerëson tipologjinë e banesave, koston e energjisë elektrike kundrejt të ardhurave, përdorimin e energjisë elektrike dhe cilësinë e jetesës si një fenomen të lidhur ngushtë me varfërinë energjetike. Vlerësimi paraqet situatën në vend, duke nxjerrë më në pah faktin që kostoja e faturës së energjisë elektrike shpesh është e papërballueshme nga familjet me të ardhura të ulëta dhe rëndon te familjet me të ardhura mesatare mujore mbi 50 000 lekë.

Rezultatet e këtij raporti faktojnë situatën aktuale në vend dhe i hapin rrugën nxitjes së politikave dhe praktikave më të mira që sigurojnë efikasitetin e energjisë, diversifikimin e burimeve për energji të pastër dhe me kosto të përballueshme nga qytetarët e shtresave të varfra dhe të mesme në Shqipëri.

Falenderojmë të gjithë të intervistuarit dhe aktorët e përfshirë në informacionin e besuar për të realizuar këtë vlerësim gjithëpërfshirës dhe pioner. Gjithashtu një falenderim i veçantë shkon për Rrjetin Ballkanik për Gazetarinë Investigative në Shqipëri (BIRN Albania) për mbështetjen e tyre mediatike.

KONCEPTI I VARËRISË ENERGJETIKE

Varfëri energjetike është situata në të cilën një familje nuk mundet të aksesojë shërbimet energjetike në shtëpi në një nivel të atillë që mund të përballojë nevojat e saj sociale dhe materiale¹. Levat që përcaktojnë nëse jemi ose jo në varfëri energjetike janë: *efiçenca e energjisë në ndërtesa, kostoja e energjisë dhe të ardhurat familjare*. Për këtë arsye në vendet e Evropës, varfëria energjetike i referohet në mënyrë të përgjithshme situatës ku individët **nuk janë në gjendje të sigurojnë energjinë e nevojshme në banesë me një çmim të përballueshëm**. Koncepti është i fuqishëm dhe analizon tre shtylla të rëndësishme: *politikat e energjisë, politikat sociale dhe praktikatat e efiçencës së energjisë*² (Figura 1).




Figura 1: Tre shtyllat që ndërlidhen për konceptin e varfërisë energjetike

Nuk është një koncept thjesht fizik, por është i ndërlidhur me çdo aspekt tjetër të jetës duke qenë një nga faktorët kyç të ekzistencës së njerëzimit në kohët moderne. Në dekadat e ardhshme sektori i energjisë do të përballë me shndërrime të cilat lidhen me a) *ndryshimet klimatike* b) *sigurimin e furnizimit me energji* dhe c) *varfërinë energjetike*³. Dy pikat e para janë koncepte dhe praktika më të studiuara dhe më të trajtuara në sektorin e politikave, si dhe në nivelin e informimit dhe ndërgjegjësimit qytetar, ndërkohë që varfëria energjetike është një koncept shumë pak i njohur dhe i trajtuar edhe pse është i lidhur ngushtësisht me jetën e qytetarëve. Banesat rrezikohen nga varfëria energjetike si rezultat i pesë faktorëve⁴:

- Rritja e çmimit të energjisë elektrike është më e lartë në krahasim me rritjen e të ardhurave
- Pamundësia për të siguruar energji me çmim më të ulët
- Nevojat në rritje të familjeve për energji
- Mungesa e efiçencës në përdorimin e energjisë
- Ndërhyrjet e politikave

¹ Bouzarovski et al. 2010

² Efiçenca e energjisë është rezultati, në përqindje, i raportit ndërmjet sasisë së energjisë së dalje me sasinë e energjisë në hyrje dhe synon zvogëlimin e sasisë së energjisë të kërkuar për të siguruar shërbime dhe produktet

³ Preston et al. (2014): Fuel and poverty: A Rapid Evidence Assessment for the Joseph Rowntree Foundation. Centre for Sustainable Energy (CSE) "Karburanti dhe varfëria: Një vlerësim i shpejtë i evidencave për Fondacionin Joseph Rowntree. Qendra për Energji të Qëndrueshme (CSE)

⁴ Preston et al. (2014): Fuel and poverty: A Rapid Evidence Assessment for the Joseph Rowntree Foundation. Centre for Sustainable Energy (CSE) "Karburanti dhe varfëria: Një vlerësim i shpejtë i evidencave për Fondacionin Joseph Rowntree. Qendra për Energji të Qëndrueshme (CSE)



Varfëria energjetike është çështje e ndërlikuar që përbën një sfidë në adresim dhe në kuptim. Janë shumë faktorë që përcaktojnë nëse një familje përballet ose jo me efektet negative të këtij fenomeni (Figura 2⁵). Politikëbërësit preferojnë të përdorin konceptin e varfërisë energjetike si një fenomen të lidhur me shtresat me të ardhura të ulta. Kjo përjashtim është e rëndësishme për të kanalizuar burimet te shtresat më në nevojë dhe pasqyron faktin që disa sisteme matëse të përdorura për vlerësimin e varfërisë energjetike klasifikojnë dhe familjet me të ardhura të mesme apo të ulta si të varfëra energjetikisht. Por, **varfëria energjetike është një koncept i nevojshëm për të kategorizuar grupet që kanë presion financiar si pasojë e faturës së energjisë elektrike, por që nuk konsiderohen të varfër nën përkufizimin e përgjithshëm të varfërisë**⁶.

Studiuesit këshillojnë se në rastin kur problemi nuk adresohet dhe nuk trajtohet në mënyrën e duhur ka ndikime në përkeqësimin e shëndetit të banorëve, në thellimin e varfërisë madje deri në pengimin e politikave që adresojnë ndryshimet klimatike⁷.



Figura 2: Faktorët që përshkruajnë varfërinë energjetike

Është e rëndësishme që ky koncept të njihet dhe të adresohet duke qenë se sigurimi i shërbimeve bazë të energjisë është kritik që komunitetet të mos vuajnë nga ndikimet negative të treguara më sipër. **Duke marrë masat e nevojshme, mund të shmangët që**

mbështetja financiare e familjeve në nevojë të rëndojë mbi buxhetin e shtetit. Qeveria dhe rregullatorë të tjerë kanë për detyrë të mbrojnë komunitetet në nevojë dhe të parandalojnë kalimin e shtresave të ndryshme shoqërore në vulnerabël.

Mungesa e të dhënave në nivel kombëtar ndikon që ky koncept të jetë edhe më abstrakt në përshkrimin dhe trajtimin e tij⁸. Si rrjedhim, në kërkesën për ta adresuar atë sa më mirë dhe drejtë, **është e nevojshme një bazë e mirë e konsoliduar të dhënash**, pasi sigurimi i tyre është çelësi për të përcaktuar dhe raportuar situatën aktuale, si dhe për të drejtuar përpjekjet dhe masat që duhet të ndërmerren në të ardhmen.

⁵ S. Robic (2016): Varfëria energjetike në Evropën Juglindore: Të mbijetuarit gjatë të ftohtit

⁶ Hills, J. (2012): Getting the measure of fuel poverty: Final Report of the Fuel Poverty Review. CASE report 72. ISSN 1465 - 3001. Centre for Analysis of Social Exclusion, London School of Economics and Political Science

⁷ www.ec.europa.eu/energy/sites/ener/files/documents/Selecting%20Indicators%20to%20Measure%20Energy%20Poverty.pdf

⁸ Ky studim sipas këtij koncepti është kryer në të gjithë rajonin e ish Jugosllavisë nga organizatat mjedisore dhe për herë të parë propozohet në Shqipëri. Reduce Energy use And Change Habits www.reach-energy.eu

Në kuadër të *acquis communautaire*,⁹ ideja e varfërisë energjetike për herë të parë ka hyrë në kornizën ligjore të Bashkimit Evropian (BE) përmes të ashtuquajturës "Paketa e Tretë Energjetike" ku u përkufizua mbrojtja e konsumatorëve me qëllim uljen e varfërisë energjetike. Në bazë të Direktivave të Tregut të Brendshëm të BE-së për Energjinë Elektrike (2009/72/EC) dhe Gazin Natyror (2009/73/EC), shtetet anëtare duhet të përkufizojnë varfërinë energjetike dhe të mbrojnë konsumatorët e energjisë.

Në kuadër të procesit të integritimit, edhe në sektorin e energjisë baza ligjore e vendit pëngrihet duke përafruar legjislacionin e BE-së. Prej vitit 2006 Shqipëria është pjesë e Komunitetit të Energjisë¹⁰ dhe si e tillë është e detyruar të përmbushë detyrimet që përmban ky anëtarësim. Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MEI) është organi kompetent për hartimin e legjislacionit dhe për raportimet në Komunitetin e Energjisë.

Me adoptimin e ligjit **Për efikasitetin e energjisë**¹¹ i cili ka për qëllim hartimin e rregullave dhe politikave kombëtare për nxitjen, promovimin e përmirësimin e përdorimit efikas të energjisë, me synim kursimin e energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit, si dhe heqjen e pengesave në tregun e energjisë dhe vendosjen e objektivave kombëtarë të efikasitetit të energjisë, është miratuar formalisht krijimi i Agjencisë së Efikasitetit të Energjisë në dhjetor 2016. Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, pika 1, të ligjit për efikasitetin e energjisë është miratuar nga Këshilli i Ministrave **Plani i dytë dhe i tretë Kombëtar i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë për Shqipërinë (PKVEE), 2017–2020**¹² i cili synon të ofrojë një vështrim gjithëpërfshirës mbi statusin e zbatimit dhe planet e ardhshme të politikave për efikasitetin e energjisë në Shqipëri, si dhe përputhshmërinë e tyre me angazhimet e vendit në kuadrin e Komunitetit të Energjisë.

Në përputhje me detyrimet e Shqipërisë në Komunitetin e Energjisë është miratuar ligji **Për burimet e energjisë së rinovueshme**¹³ përafruar plotësisht me Direktivën 2009/28/KE si dhe është miratuar **Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme (PKVBER)**¹⁴, i cili përcakton objektivin që, deri në 2020, 38% e konsumit final të energjisë të jetë nga burimet e energjive të rinovueshme dhe përcakton masat e synuara për përmbushjen e tij. Më tej, në 2017, është miratuar ligji **Për nxitjen e**

⁹ Acquis Communautaire (acquis) përfshin të gjithë legjislacionin e BE-së të miratuar nga institucionet e saj

¹⁰ Komuniteti i Energjisë është një organizatë ndërkombëtare e cila bashkon Bashkimin Evropian dhe vendet fqinje të saj për të krijuar një treg të integruar evropian të energjisë


¹¹ Ligj nr. 124/2015 "Për efikasitetin e energjisë"

¹² Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 1.12.2017 Për miratimin e planit të dytë dhe të tretë kombëtar të veprimit për efikasitetin e energjisë për Shqipërinë 2017–2020 www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2017/PDF-2017/214-2017.pdf

¹³ Ligji nr. 26/2014 Për disa ndryshime në ligjin nr. 138/2013 "Për burimet e energjisë së rinovueshme"

"Burime të rinovueshme të energjisë" janë burimet e rinovueshme jofosile të energjisë, si era, energjia diellore, energjia aerotermale, energjia gjeotermale, energjia hidrotermale dhe oqeanike, energjia hidrike, biomasa, gazi i përfutur prej vendgropësjes së mbetjeve, gazi i përfutur prej impianteve të trajtimit të ujërave të zeza dhe biogazi, siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi për burimet e energjisë së rinovueshme

¹⁴ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 20.1.2016 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme 2015 – 2020"



përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme¹⁵ përafruar pjesërisht me Direktivën 2009/28/KE. Ai nxit rritjen e prodhimit të energjisë prej burimeve të rinovueshme për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Në vitin 2015 është miratuar ligji **Për sektorin e energjisë elektrike**¹⁶. Qëllimi i këtij ligji është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Duke filluar prej datës 1 janar 2015 ka filluar mënyra e re e tarifimit të energjisë elektrike duke mos patur më përshkallëzime të çmimit të energjisë elektrike për familjarët me dy nivele, nën dhe mbi 300 kWh, dhe të gjithë konsumatorët familjarë të energjisë elektrike do të paguajnë 9.5 lekë për kWh pa tvsh. **Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kWh në muaj**, këshilli i ministrave ka miratuar një vendim të posaçëm i cili kompenson diferencën e çmimit të energjisë elektrike për mbrojtjen e këtyre shtresave¹⁷.

Një ndër sukseset më të fundit të qeverisë është pikërisht plotësimi i mëtejshëm i paketës së efikasitetit të energjisë. Në nëntor të vitit 2016 është adaptuar nga parlamenti shqiptar ligji **Për performancën e energjisë së ndërtesave**¹⁸ përafruar pjesërisht me direktivën 2010/31/BE, i cili ka për qëllim krijimin e kuadrit ligjor për përmirësimin e performancës së energjisë së ndërtesave, duke marrë në konsideratë kushtet lokale dhe klimaterike të vendit, kushtet e komfortit të brendshëm të ndërtesave, si dhe kostot efektive.

¹⁵ Ligj nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"

¹⁶ Ligj nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"

¹⁷ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 14.1.2015 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kWh në muaj"

¹⁸ Ligji nr. 116/2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave"



METODA

Vlerësimi i varfërisë energjetike është kryer në periudhën korrik – shtator 2017 në 5 qytete të vendit: Shkodër, Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Berat¹⁹, të cilat kanë shtrirje gjeografike si dhe profile të ndryshme. Grupi i synuar përfaqëson 6 kategori: 1) *Familje vulnerabël* 2) *Familje të zgjedhura rastësisht* 3) *Institucione edukimi publik (çerdhe, kopshte, shkolla, universitete)* 4) *Administrata publike* 5) *Institucione shëndetësore publike dhe* 6) *Hotele*.

Kampioni

Kampioni i marrë për vlerësim përfaqësohet nga **1954** njësi të shpërndara sipas figures 3²⁰ dhe tabelës më poshtë:

Tabela 1. Shpërndarja e kampionit për secilin qytet

Grupi i synuar	Qyteti					TOTAL
	Tirana	Berat	Vlorë	Elbasan	Shkodra	
Familje vulnerabël	110	29	40	45	49	273
Familje në përgjithësi	502	159	221	193	191	1266
Total njësi ekonomike familjare	612	188	261	238	240	1539
Institucione edukimi publik (çerdhe, universitet, shkolla, kopsht)	56	20	24	20	20	140
Administrata publike	55	15	9	15	15	109
Institucione shëndetësore publike	20	6	1	7	7	41
Hotele	60	20	5	20	20	125
Total njësi të tjera	191	61	39	62	62	415
TOTAL	803	249	300	300	302	1954

Përmasa e kampionit të përzgjedhur për secilin qytet është llogaritur për të siguruar një rezultat statistikisht të besueshëm në nivelin 95% mbështetur edhe në popullsinë e secilës njësi bashkiake sipas të dhënave të censusit 2011. Përmasa për nëngrupet me interes krahasimi është marrë minimalisht 100, niveli minimal i pranuar statistikisht.


Grumbullimi i të dhënave

Për grumbullimin e të dhënave është përdorur një pyetësor i huazuar dhe përshtatur nga projekti REACH²¹ i cili ka bërë këtë vlerësim për të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë. Në Shqipëri është hera e parë që zhvillohet ky studim. Pyetësori për njësitë familjare përmban 50 pyetje: 18 pyetje me karakter socio-ekonomik dhe shëndetësor, dhe 32 pyetje me

¹⁹ Për t'u informuar rreth raporteve vlerësuese për secilin qytet gjeni në shtojcë kontaktet e secilës organizatë për qytet

²⁰ Hartat e shpërndarjes së kampionit sipas koordinatave GPS për secilin qytet gjenden në shtojcë

²¹ REACH www.reach-energy.eu (Reduce Energy use And Change Habits) zbatuar në Bullgari, Kroaci, Maqedoni, Slloveni).



karakter energjetik. Ndërsa pyetësi për njësitë e tjera²² përmban vetëm 32 pyetjet me karakterin energjetik.

Metoda e grumbullimit ka qenë me intervista të drejtpërdrejta në zonën e përcaktuar për të realizuar vlerësimin, zona urbane brenda njësisë bashkiake. Anektuesit (24) u trajnuan dhe testuan paraprakisht pyetësin. Familjet u përzgjedhën rastësisht duke patur parasysh ndarjen administrative të secilit qytet, por me një shpërndarje gjeografike dhe me tipologji banese të ndryshme. Familjet vulnerabël janë përzgjedhur sipas një liste nga komunikimi zyrtar me Drejtorinë Bashkiake të Shërbimeve Sociale të secilit qytet, dhe në rastet e mungesës së listave është bashkëpunuar me Organizatën Shoqërore të Përkrahjes së të Rinjve (ARSIS) si dhe janë zhvilluar pyetësit në godinat sociale bashkiake. Hotelet, institucionet e edukimit publik, institucionet e shëndetit publik dhe administrata publike janë përzgjedhur rastësisht.

Hedhja dhe përpunimi i të dhënave

Në programin SPSS (Paketa Statistikore për Shkencat Sociale) version 20 (IBM statistics 2011) u ngrit një databazë e posaçme për vlerësimin, prej nga u hodhën dhe u përpunuan të dhënat. Paraqitja grafike e të dhënave është realizuar me paketën Microsoft Excel 2010. Hartat janë ndërtuar në Q-Gis dhe Illustrator.

²² Në vijimësi për lehtësi përshkrimi do të përdoret fjala institucione për kategorinë "njësi të tjera"



Shpërndarja e kampionit





Figura 3: Shpërndarja e kampionit



Njësi ekonomike familjare

1. Përshkrimi i kampionit

Për këtë raport vlerësues është marrë në shqyrtim një kampion prej 1539 njësi ekonomike familjare. Mosha mesatare e të intervistuarve është 47 vjeç dhe numri mesatar i personave në banesë 3.6. Sipas gjinisë, personat e intervistuar përkojnë me 54% femra dhe 46% meshkuj; 67% prej tyre rezultojnë të martuar. Ndër të intervistuarit pothuajse gjysma e tyre është e punësuar (52%), 38% kanë nivel të mesëm arsimit dhe 35% nivel të lartë. Sipërfaqja mesatare e banesave është 85 m², ku banesat e tipit apartament llogariten ~73% dhe shtëpitë private ~27%.

Për sa i përket gjendjes shëndetësore, të anketuarit janë shprehur se gjatë katër javëve të fundit deri në kohën e realizimit të intervistave: nuk kanë patur asnjëherë probleme në punë apo në shtëpi (~38%) si pasojë e problemeve shëndetësore; asnjëherë (~30%) dhe rrallë (~26%) kanë përjetuar dhembje fizike; 55% nuk kanë humbur asnjëherë besimin në vetvete dhe 51% nuk e kanë përjetuar ndjesinë për të mos i bërë ballë problemeve. Në lidhjen që ekziston mes problemeve shëndetësore dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e aktiviteteve sociale rezulton se në 41% të rasteve asnjëherë nuk ka ndikim, dhe në 23% të rasteve ndikon ndonjëherë. Gjendja shëndetësore vlerësohet nga të anketuarit si e mirë në 34% të të intervistuarve, e kënaqshme në 26%, shumë e mirë dhe e dobët në 18% dhe 17%, dhe pjesa tjetër e vlerësojnë si të shkëlqyer.

Të anketuarit janë pyetur dhe për vlerësimin e jetës së tyre ku ~51% shprehen që janë "as të lumtur as të palumtur", ~42% shprehen se janë të lumtur. Përqindja e të anketuarve të cilët janë shprehur se janë të palumtur është 7%.

2. Tipologjia e banesës

Një tipar i vlefshëm që merret në shqyrtim në momentin e vlerësimit të performancës së energjisë së banesave është mosha e banesës. Mosha e banesës ka këto luhajtje në kampion: ~27% e banesave janë të vjetra midis 36-60 viteve; ~25% e banesave janë me moshë 26-35 vite dhe po aq me moshë 6-25 vite; ndërtesat më të reja (<5 vite) dhe ndërtesat më të vjetra (>60 vite) zënë përqindje pothuajse të njëjtë në kampion (rreth 10%) (Figura 4).

Është matur temperatura brenda dhe jashtë ndërtesës dhe ka rezultuar se nuk ka diferencë të ndjeshme midis temperaturës së këtyre dy mjediseve të ndryshme (temperatura mesatare e brendshme 28°C dhe mesatare e jashtme 33°C).

Për sa më sipër, mund të themi se pavarësisht moshës që kanë banesat e marra në shqyrtim, ato *nuk përputhen me parimet e termoizolimit*. Kushtet e brendshme të një banese duhet të jenë më optimale dhe të sigurojnë ambient të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve jetësore.





Figura 4: Mosha e banesës

Të pyetur, 60% e të intervistuarve janë të kënaqur me temperaturën e banesës së tyre, pjesa tjetër i vlerësojnë banesat e tyre si shumë të nxehta (8.6%) dhe si shumë të ftohta (31.4%).

Pavarësisht përqindjes së lartë të kënaqësisë me temperaturat e brendshme të banesës, nuk duhet të neglizhohet edhe përqindja e atyre të intervistuarve që janë të pakënaqur me këto temperatura. Këtu vlen për tu theksuar nevoja për të marrë masa konkrete në sigurimin e shërbimeve të domosdoshme bazë jetësore, sikundër janë ftohja dhe ngrohja, veçanërisht gjatë ditëve të nxehta e atyre të ftohta.

Megjithatë, rezulton se perceptimi i banorëve për temperaturën në ambientin e brendshëm gjatë stinës së dimrit ndryshon në varësi të moshës së ndërtesës së banimit. Tendencia që vihet re është: me rritjen e moshës së ndërtesave të banimit rritet edhe pakënaqësia në lidhje me të ftohtin. Konkretisht 46.3% e familjeve që jetojnë në ndërtesa më shumë se 60 vjeçare shprehen se kanë probleme me të ftohtin. Ndërkohë që banorët në banesat e reja (<5 vjet) janë ~80% të kënaqur me temperaturën në ambientet e tyre gjatë stinës së dimrit.

Dritaret dhe dyert ku kalojnë rryma ajri janë shkak i uljes së efijencës së një banese. Në banesat e vlerësuara, rreth 37% kanë dyer dhe dritare të cilat lejojnë kalimin e rrymave të ajrit; rreth 7% e tyre janë pjesërisht hermetike; dhe rreth 57% nuk lejojnë aspak kalimin e rrymave të ajrit (Figura 5).



Dritare dhe dyer ku kalojnë rryma ajri




Figura 5: Dritare dhe dyer ku kalojnë rryma ajri

Megjithatë vihet re një lidhje e ngushtë midis moshës së banesës dhe pranisë së dritareve dhe dyerve prej nga kalojnë rryma ajri. Banesat më të reja janë më hermetike ndërkohë që banesat më të vjetra vuajnë nga kalimi i rrymave të ajrit në dyer dhe dritare (Figura 6). Pothuajse 80% e banesave të reja (<5 vite) nuk kanë dritare dhe dyer ku kalojnë rryma ajri. Ndërkohë më shumë se gjysma e banesave të vjetra (>60 vite) kanë dyer dhe dritare ku kalojnë rryma ajri. Vihet re një përmirësim i izolimit të dyerve dhe dritareve në banesat 36-60 vjeçare, i cili zvogëlohet në banesat e ndërtuara midis viteve 1983 dhe 1992. Këto ndërtesa (26-35 vite) përfaqësojnë grupin e dytë me izolim më të dobët të dyerve dhe dritareve, ~50% e kampionit kanë dyer dhe dritare ku kalojnë rryma ajri. Pas viteve 1992 cilësia e banesave në këtë drejtim rritet. Kjo lidhet edhe me hapjen e tregut drejt metodave dhe modeleve më të mira të ndërtimit.




Figura 6: Dritare dhe dyer ku kalojnë rryma ajri sipas moshës së ndërtesës

Lagështia e ajrit dhe prania e mykut janë dy faktorë të cilët lidhen drejtpërdrejtë me shëndetin e secilit individ dhe më tej me zhvillimin e aktiviteteve sociale. Në përgjithësi të intervistuarit (72.5%) janë të kënaqur me cilësinë e ajrit në banesën e tyre dhe nuk kanë

probleme me mykun (72%). Megjithatë vihet re një lidhje e moshës së banesës me mykun. Banorët e ndërtesave të reja (<5 vjet) në masën ~90% nuk kanë probleme me mykun në banesën e tyre. Kjo tregon rëndësinë që i është kushtuar ndërtesave të reja për rritjen e standardit në investime që qëndrojnë sa më afër plotësimit të kushteve optimale²³ të jetesës në banesë. Banorët në ndërtesa më të vjetra se 60 vite kanë në masën 45% probleme me mykun në banesën e tyre, dhe e cilësojnë ajrin e brendshëm shumë të lagësht (55%). Sikundër vihet re në figurën 7 ka një përmirësim shumë të theksuar në mungesën e mykut në banesat e pas viteve 1992. Ndërkohë ky përmirësim është më pak i ndjeshëm në banesat nga vitet 1958 deri në 1991.




Figura 7: Probleme me mykun në banesë në varësi të moshës së banesës

Një ndër masat për të rritur efikasitetin në banesa bazohet dhe në izolimin e ambientit të banimit. Në këtë vlerësim pjesa më e madhe e banesave të marra në shqyrtim kanë izolim të plotë (mure, çati, dyshe) (30%), të pjesshëm (28%)²⁴, vetëm të mureve (17%). Vlen për tu theksuar se vetëm 25% e kampionit shprehen se nuk kanë izolim. Përqindja e banesave që kanë izolim (të plotë dhe të pjesshëm) pavarësisht moshës së tyre, është më e lartë krahasuar me banesat që nuk kanë izolim.

Në varësi të moshës së banesës vihet re që niveli i izolimit ndryshon, kjo edhe për faktin se investimet dhe kërkesa për izolim është në rritje me kalimin e viteve. Megjithatë, sërish problematike shfaqen ndërtesat midis viteve 1983 dhe 1992 (26-35 vite) të cilat kanë izolim të plotë në masën më të vogël (~17%). Banesat e reja (<5vite) dhe (6-25 vite) zënë përqindjen më të lartë të izolimit të plotë (~39%) dhe (43%). Banesat më të vjetra se 60 vite kanë izolim të ulët, në ~40% të këtyre banesave izolimi mungon plotësisht (Figura 8).

²³ Me kushte optimale i referohemi pasjes së vlerave optimal në banesë të faktorëve si: temperaturë e brendshme, lagështi etj.

²⁴ Izolim i pjesshëm i pjesëve të tjera të banesës (nuk përfshihen muret)






Figura 8: Tipi i izolimit në varësi të moshës së banesës

Një ndër masat për të ruajtur një temperaturë të brendshme të përshtatshme, si gjatë ditëve të ftohta ashtu edhe gjatë atyre të nxehta, është tipi i xhamave dhe i kornizave në dritare. Afërsisht 50% e banesave kanë xham tek, ~36% kanë xham dopio dhe ~21% kanë xhama të tipit tjetër. Nga vëzhgimet në terren ka një përqindje të ulët të banesave të cilat nuk kanë xhama në dritare. Në vend të tyre banorët përdornin qese plastmasi apo kartona. Këto kushte janë vërejtur në familjet me të ardhura të ulta, por është një tregues që flet për realitetin e disa banesave në kohën kur flasim për performancë të energjisë së ndërtesave.

Ndërtesat e reja (<5 vite) zënë përqindjen më të lartë të banesave me xhama dopio (~75%) ndërsa në banesat më të vjetra (36-60 vite dhe >60 vite) përqindjen më të lartë (~65%) e zënë xhamat tek (Figura 9). Vihet re se, pavarësisht nga mosha e ndërtesës, korniza e dritareve në ~70% të banesave të vlerësuara është alumin (Figura 10). Kjo nuk lidhet me preferencën e ndërtuesve, por kryesisht në banesat e vjetra (para viteve 1992) nga restaurimet që vetë familjarët kanë bërë, dhe pas këtyre viteve, nga fakti që ky model ka mbizotëruar tregun. Megjithatë vihet re një përqindje e rritur e kornizave prej druri në banesat e vjetra (36-60 vite dhe >60 vite).






Figura 9: Tipi i xhamave në varësi të moshës së banesës




Figura 10: Tipi i kornizës së dritares në varësi të moshës së banesës



3. Përdorimi i energjisë elektrike

Energjia elektrike është një nga burimet kryesore për zhvillimet e aktiviteteve jetësore. Në banesat e kampionit të vlerësimit ajo përdoret gjerësisht. ~90% e të intervistuarve e përdorin atë për ngrohjen e ujit, si në kuzhinë me boiler elektrik (~72%), ashtu edhe në tualet me boiler elektrik (~90%). ~65% përdoret për ngrohjen e ambientit dhe ~60% për ftohjen e tij. ~37% e banesave përdorin vetëm këtë burim energjie për gatim (Figura 11), një shifër kjo e konsiderueshme nëse marrim parasysh edhe familjet që përdorin alternim të energjisë elektrike me gaz, apo me biomasë etj.

Një burim tjetër i përdorur për ngrohjen e ujit në tualet dhe në kuzhinë është ngrohja me panel diellor (~3%). Ndonëse në përqindje të vogël, është për tu vlerësuar fakti që dhe pse në politikat shtetërore stimulimi i burimeve diellore për furnizimin me energji është nxitur vetëm në vitin 2017²⁵, investimet private të banorëve në këtë drejtim kanë marrë hov dhe janë tregues i vullnetit, dëshirës dhe leverdisë në këto investime.




Figura 11: Përdorimi i energjisë elektrike në familje

Për ngrohjen e ambienteve të banesës përdoret edhe biomasa (12% e banesave), dhe kryesisht banesat e para viteve 1990, e përdorin energjinë e biomasës për ngrohje. Në këtë përqindje qyteti i Shkodrës zë peshën më të madhe ku 42% e njësive ekonomike familjare përdorin biomasë për ngrohje. Kjo përqindje është më e ulët në qytetet e tjera duke u ndjekur nga Elbasani (17%), Tirana (6.2%) dhe Berati (3.2%) (Figura 12).

²⁵ Ligj nr. 7/2017 datë 2.2.2017 Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme



Konsumoni biomasë për ngrohje?




Figura 12: Konsumi i biomasës për ngrohje sipas qyteteve

Interesant është rezultati që tregon përdorimin e energjisë elektrike në masën 59.6% për pompimin e ujit. Pra, vlerësimi nxjerr në pah edhe keq funksionimin e shërbimeve të tjera në vend (në rastin konkret furnizimi me ujë), të cilat detyrojnë familjet shqiptare të rrisin konsumin e energjisë për të kompensuar këto mungesa.

Nga gjetjet duket se elektriciteti është burimi kryesor i energjisë për të siguruar shërbimet minimale të domosdoshme jetësore në vendin tonë. Por sa i kushton kjo familjeve?

4. Kostoja e energjisë elektrike

Familjet e kampionit të vlerësimit kanë të ardhura mesatare mujore që variojnë nga më pak se 10 000 Lekë në muaj deri në mbi 50 000 Lekë në muaj. Shpërndarja e kampionit sipas fashave së të ardhurave mesatare mujore jepet në tabelën 2.

Tabela 2. Shpërndarja e kampionit sipas fashave së të ardhurave mesatare mujore

Të ardhurat mesatare mujore (Lek)	Nën 10 000	10 000 – 25 000	25 000 – 35 000	35 000 – 50 000	Mbi 50 000
Përmasa e familjeve në kampionin e vlerësimit	6%	16%	17%	21%	40%

Sa % e këtyre të ardhurave i shkon familjeve për sigurimin e shërbimeve bazë të domosdoshme jetësore? Pra, sa % e të ardhurave shkon për pagesën e faturës së energjisë?




Tabela 3. Të ardhurat mesatare mujore dhe kostoja e energjisë elektrike

Të ardhurat mesatare mujore të familjes (Lek)	Kosto mesatare mujore për energjinë elektrike (Lek)	Sasia e të ardhurave që shkon për faturën e energjisë elektrike
Nën 10 000	3.607,00	jo më pak se 36%
10 000 – 25 000	3.411,00	19.5%
25 000 – 35 000	3.830,00	13%
35 000 – 50 000	4.332,00	10%
Mbi 50 000	5.868,00	jo më shumë se 12%

Shihet qartë sipas tabelës 3, se familjet të cilat kanë të ardhura mujore më të larta kanë edhe kosto mesatare mujore të energjisë elektrike më të lartë nëse e krahasojmë me familjet me të ardhura më të ulëta.

Si përfundim familjet me të ardhura mesatare mujore mbi 50 000 lekë në krahasim me familjet me të ardhura mesatare mujore nën 10 000 lekë, paguajnë një kosto mesatare mujore të energjisë elektrike vetëm 1.6 herë më shumë. Del qartë në pah vështirësia që kanë familjet me të ardhura jo të larta në përballimin dhe të shpenzimeve të tjera jetësore përveç pagesës së faturës së energjisë elektrike.

Megjithatë e përkthyer në % së të ardhurave familjare që shkon për të paguar faturën e energjisë elektrike, familjet me të ardhura më të larta janë në kushte shumë më të favorshme. Nëse familjet me të ardhura nën 10 000 Lekë/muaj duhet të shpenzojnë **jo më pak se 36%** së të ardhurave për faturën e energjisë elektrike, familjet me të ardhura mbi 50 000 Lekë/muaj shpenzojnë **jo më shumë se 12%** së të ardhurave të tyre për sigurimin e elektricitetit të nevojshëm (Tabela 3).

Të pyetur për vlerësimin e jetës së tyre në lidhje me lumturinë familjet me të ardhura më të ulta nën 10 000 lekë kanë nivelin më të ulët të lumturisë (14% e tyre janë shprehur se janë të lumtur, 68% as i lumtur as i palumtur dhe 18% të palumtur). Në këto nivele të ngjashme shprehen dhe familjet me të ardhura nën 25 000 lekë. Është interesante nga perceptimi që kanë të intervistuarit ku me rritjen e të ardhurave mesatare mujore rritet dhe perceptimi i tyre për lumturinë dhe ulët perceptimi për jetë si të pa lumtur. Familjet të cilat kanë të ardhura mbi 50 000 lekë kanë dhe perceptimin më të madh të lumturisë (~58% të lumtur). Ndërkohë që perceptimi as i lumtur as i palumtur ka pothuajse të njëjtën përqindje në fashat 10 000 – 50 000 lekë

Kostoja mesatare e energjisë elektrike e paguar në dimër është më e lartë se kostoja mesatare e energjisë elektrike paguar në verë në të gjitha familjet. Kjo mund të kuptohet edhe nga të dhënat e figurës 11: Përdorimi i energjisë elektrike në familje.

Këto rezultate tregojnë që, duhet të ekzistojnë më tepër masa dhe politika që mbështesin financiarisht shtresa të ndryshe qofshin në nevojë apo jo për të përballuar dhe përmbushur çdo kërkesë minimale jetese.



Të pyetur nëse hasin vështirësi në pagesën e faturës së energjisë elektrike, 62% e të intervistuarve janë përgjigjur PO. Një % e konsiderueshme pavarësisht nivelit të të ardhurave. Kjo vështirësi, sipas rezultateve të marra më sipër, përkthehet në vështirësi për sigurimin e shërbimeve bazë të domosdoshme jetësore. Megjithatë ka diferenca të shkallës së vështirësisë në varësi të fashave të të ardhurave. Është e kuptueshme që familjet me të ardhura nën 10 000 Lekë janë më të prekura, por interesant është fakti që edhe fashat e tjera (përveç atyre me të ardhura mbi 50 000 Lekë) hasin vështirësi në nivele të larta (nga 69 – 87%) (Figura 13).




Figura 13: Vështirësi në pagesën e faturës mesatare mujore të energjisë elektrike sipas të ardhurave mesatare mujore për familje

Pavarësisht të ardhurave mujore dhe vështirësisë në pagesën e faturës së energjisë elektrike, ~72% e të gjithë familjeve të kampionit konsumojnë më pak energji elektrike se sa u nevojitet, kryesisht gjatë stinës së dimrit. Ata e realizojnë këtë duke ndërmarrë veprime kursimi si: Reduktimi i ngrohjes (fikja e ngrohjes, ngrohja vetën e një dhome etj.); Fikja e dritave në shtëpi; Përdorimi më pak i ujit të ngrohtë; Konsumimi i më pak ushqimeve dhe pijeve të ngrohta gjatë dimrit, etj.

Sipas të ardhurave mesatare mujore, këto veprime paraqiten në % në figurën 14. 94% e familjeve me të ardhura mesatare mujore nën 10 000 Lekë (gati të gjitha) kryejnë veprime kursimi për të ulur dhe përballuar koston e energjisë elektrike. Kjo shifër mbetet e lartë në të gjitha fashat, madje mbi 50% edhe në familjet me të ardhura mbi 50 000 Lekë.




Figura 14: Përqindja e sjelljeve të ndërmarra për të konsumuar më pak energji sesa nevojitet, sipas të ardhurave mesatare mujore të familjeve



Njësi të tjera ndërtesash

1. Tipologjia e ndërtesës

Janë vlerësuar 415 njësi të tjera ndërtesash të cilat i përkasin kategorive: Hotele (30%), institucione shëndetësore (10%), administratë publike (26%) dhe institucione edukimi publik (34%). Të bie në sy (Figura 15) që këto njësi ndërtesash në përgjithësi janë më të vjetra se 6 vjeçare, vetëm 4% e tyre janë ndërtuar në 5 vitet e fundit.

Mosha e ndërtesës




Figura 15: Mosha e institucioneve të vlerësuara




Figura 16: Mosha e institucioneve të vlerësuara sipas kategorisë

Hotelet dhe institucionet shëndetësore kanë kryesisht ndërtesa të ngritura midis 6 dhe 25 viteve të fundit; ndërkohë që institucionet e edukimit publik dhe administrata publike kanë

ndërtesa më të vjetra të ngritura midis 36-60 viteve të fundit gjë e cila përkon edhe me fuqizimin dhe shtrirjen e këtyre sektorëve (qeverisja dhe edukimi) (Figura 16).




Figura 17: Izolimi sipas kategorisë së institucionit

Grafiku i figurës 17 na tregon se pjesa më e madhe e ndërtesave të institucioneve të marra në vlerësim kanë izolim të plotë ose të pjesshëm. Institucionet shëndetësore janë të gjitha me izolim, ndërkohë që institucionet e edukimit dhe administrata kanë nevojë për investime në këtë drejtim. Përkatësisht 20% dhe 23.9% e ndërtesave të tyre nuk kanë izolim të asnjë lloji.




Figura 18: Izolimi i institucioneve sipas kategorisë dhe moshës së institucionit (Hotel dhe administratë publike)




Figura 19: Izolimi i institucioneve sipas kategorisë dhe moshës së institucionit (Institucione të edukimit publik dhe institucione të shëndetit publik)

E parë në këndvështrimin e një investimi të mundshëm në të ardhmen e afërt për të përmirësuar izolimin në këto institucione të rëndësishme (kryesisht ato publike), është bërë një analizë e moshës së institucionit dhe izolimit të tij e cila pasqyrohet në grafikët e figurave 18 dhe 19.

Në institucionet e administratës publike prioritet duhet t'i jepet ndërtesave duke filluar nga vitet 6-25 dhe në fashat e tjera të ndërtesave më të vjetra, ku mungesa e izolimit është në përqindje të rritur. Në ndërtesat ndërmjet viteve 1982-1991 mungesa e izolimit arrin përqindjen më të lartë 28%. Në institucionet e shëndetit publik, duke konsideruar rëndësinë e tyre, duhet filluar investimi kryesisht në ndërtesat e ngritura midis 36 dhe 60 vite më parë, ku në të gjitha mungon izolimi i plotë. Institucionet edukuese shfaqen më problematike pasi kanë një tendencë në ndërtesat e 5 viteve të fundit të ulin investimin në izolim (33.3% e tyre nuk kanë asnjë izolim dhe kjo është shifra më e lartë e të gjitha fashave të moshës të këtyre ndërtesave).

Hotelet janë njësia me përqindjen më të lartë të izolimit të plotë në të gjitha moshat e vlerësuara.

Institucionet u vlerësuan dhe për tipin e xhamave, kornizën e dritares, praninë e dyerve dhe dritareve ku kalojnë rryma ajri, si dhe nëse kanë probleme me mykun. Këto tipare të ndërtesës janë faktorë të cilët ndikojnë në efikasitetin e një ndërtese.

Nuk ka një diferencë të ndjeshme në kampionin e vlerësuar midis pranisë së xhamave dopio apo tek (~46% dhe ~51%), por këtë rezultat e ndikojnë hotelet të cilët kanë xhamë dopio në masën 80%, ndërkohë që pjesa më e madhe e institucioneve të vlerësuara kanë xhamë tek (Figura 20).

Rreth 86% e ndërtesave kanë korniza alumini dhe rreth 63% nuk kanë as dritare e as dyer ku kalojnë rryma ajri. Në figurën 21 tregohet tipi i kornizës së dritares sipas kategorisë së institucionit. Rezultatet tregojnë se ndërtesat e vlerësuara kanë më tepër dyer ku kalojnë rryma ajri se sa dritare që lejojnë kalimin e rrymave të ajrit. Institucionet shëndetësore kanë në masën ~56% dyer dhe dritare ku kalojnë rrymat e ajrit. Hotelet, edhe pse në masën rreth 60% të izoluar plotësisht, në masën ~35% tregojnë se kanë dyer dhe dritare ku kalojnë rryma ajri (Figura 22).

74 % e të intervistuarve shprehen se nuk kanë probleme me mykun në ndërtesat ku punojnë, megjithatë sipas kategorisë, institucionet e edukimit publik, administratës publike dhe institucionet shëndetësore, në masën ~30% shprehen se kanë probleme me mykun (Figura 23).

Tipi i xhamave në dritare




Figura 20: Tipi i xhamave në dritare sipas kategorisë së institucionit





Figura 21: Tipi i kornizave në dritare sipas kategorisë së institucionit






Figura 22: Kalimi i rrymave të ajrit në dritare dhe dyer sipas kategorisë së institucionit




Figura 23: Prania ose mungesa e mykun në institucion sipas kategorisë

Tiparet e vlerësuara (izolimi, tipi i xhamave, rrymat e ajrit etj) janë të lidhura ngushtësisht si me efikasitetin e një institucioni, ashtu edhe me shëndetin e punonjësve të tij. Shëndeti më tej bëhet faktor ndikues në performancën e punonjësve brenda orarit të punës dhe zhvillimin e aktiviteteve normale jetësore.



Të gjitha institucionet shëndetësore të ndërtuara më shumë se 60 vite më parë kanë probleme me mykun, dhe ndërtesat e këtyre institucioneve të ngritura 6-25 vite më parë kanë tendencë në rritje për praninë e mykut. Institucionet e edukimit publik janë kategoria që kanë më shumë probleme me praninë e mykut, pra vuajnë nga lagështia. Vëmëndje u duhet kushtuar kryesisht ndërtesave të ngritura 6-25 vite më parë. Ndërtesat e 5 vjeçarit të fundit të administratës publike nuk kanë probleme me mykun, ndërsa ato në gjithë vitet e tjera në masën afërsisht ~33% (Figura 24).





Figura 24: Probleme me mykun në institucion sipas kategorisë së institucionit dhe moshës

Matja e temperaturës brenda ndërtesës dhe krahasimi me temeperaturën jashtë saj tregon diferencë mesatare prej 5°C më pak brenda se jashtë (përkatësisht 25°C dhe 30°C).

Të pyetur nëse janë të kënaqur me temperaturën e ndërtesës ku punojnë gjatë stinës së dimrit dhe me lagështinë e ajrit, afërsisht 72% janë shprehur "po". Megjithatë, vlen të theksohet se institucionet e edukimit publik dhe administrata publike shprehen se është shumë ftohtë në dimër (44.3% dhe 24%) dhe ajri është shumë i lagësht (37% dhe 21%). Gjithashtu, 22% e institucioneve shëndetësore shprehen se ajri është shumë i lagësht.



2. Përdorimi i energjisë elektrike

Pavarësisht se flasim për ndërtesa të tjera, kryesisht të karakterit institucional, vihet re se energjia elektrike është burimi kryesor për sigurimin e të njëjta shërbimeve. Si edhe në rastin e njësive ekonomike familjare, dhe këtu përqindjen më të lartë e zë ngrohja e ambientit (75.2%) (Figura 25). Shifrat e larta për shërbime si ngrohja e ujit dhe pompimi i ujit ndikohen nga kategoria hotele. Vlen për tu theksuar se rreth 8% e ndërtesave të vlerësuara përdorin panele diellore për ngrohjen e ujit në banjë dhe kuzhinë. Kategoria me përqindjen më të lartë të përdorimit të panelit diellor për ngrohje të ujit është hoteli (rreth 26.4% e tyre përdorin panelin diellor për ngrohje të ujit). Kategoritë e tjera kanë përqindje të ulta (nën 2.5% për kategori). Rreth 60% e hoteleve përdorin për gatim vetëm energji elektrike.

Institucionet shëndetësore dhe administrata publike janë ndërtesat me përqindjen më të lartë të përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje ambienti (90% dhe 92%) dhe ftohje ambienti (85.4% dhe 89.9%). Institucionet e edukimit janë ato që e përdorin më pak energjinë elektrike në këtë drejtim, por kjo përkthehet që këto institucione kanë probleme me ngrohjen dhe ftohjen e ambienteve të tyre (Figura 26 dhe 27). Ndërkohë që burime të tjera për ngrohje janë identifikuar gazi dhe biomasa, ku përqindjen më të lartë të përdorimit të gazit dhe biomasës e zënë hotelet (7% dhe 20%) ndërsa njësitë e tjera janë në përqindje më të ulët: Institucionet e edukimit publik - biomasë 3.6% dhe gaz 12.9%; Administratë publike - gaz 1.8%; Qendrat shëndetësore - gaz 9.8%.

Ndërtesat të cilat përdorin në përqindje të lartë energjinë elektrike për ngrohjen e ujit janë hotelet (81%) dhe më tej renditen institucionet e tjera (Figura 28) të cilat nuk kanë ndryshim thelbësor midis tyre, edhe pse logjika të çon drejt mendimit që institucionet shëndetësore duhet të kishin një % të ndjeshme më të lartë. Përsëri hotelet renditen në përqindjen më të lartë për pompimin e ujit duke përdorur energjinë elektrike pasi aktivitetet e tyre janë të ngjashme, por më intensive, sikundër njësitë ekonomike familjare (Figura 29).




Figura 25: Përdorimi i energjisë elektrike në institucion sipas komoditetit

Ngrohja e ambientit




Figura 26: Përdorimi i energjisë elektrike për ngrohje të ambientit sipas kategorisë së institucionit

Ftohje ambienti




Figura 27: Përdorimi i energjisë elektrike për ftohjen e ambientit sipas kategorisë së institucionit



Ngrohje uji




Figura 28: Përdorimi i energjisë elektrike për ngrohjen e ujit sipas kategorisë së institucionit

Pompim uji




Figura 29: Përdorimi i energjisë elektrike për pompimin e ujit sipas kategorisë së institucionit

3. Kostoja e energjisë elektrike

Kostoja e faturës së energjisë elektrike sipas informacionit të siguruar nuk ka peshë të ndjeshme në buxhetin vjetor të kategorive të vlerësuara (Tabela 4). Më pak se 1% e buxhetit mesatar vjetor të institucioneve publike shkon për pagesën e faturës së energjisë, por për hotelet (aktiviteti i të cilave ka ritme të shumëfishuara të njërive ekonomike familjare) ~10% e të ardhurave mesatare vjetore shkojnë për pagesën e faturës së energjisë elektrike.

Tabela 4. Të ardhurat mesatare vjetore dhe kostoja e energjisë elektrike

Kategoria e ndërtesës	Buxheti mesatar vjetor për institucion (Lek)	Kosto mesatare vjetore e energjisë elektrike (Lek)	Pjesa e buxhetit që shkon për faturën e energjisë elektrike (%)
Institucione të edukimit publik	77.247.507,85	574.752,86	0.74%
Administratë publike	738.945 .517,71	2.652.619,56	0.36%
Institucionet të shëndetit publik	98.720.295,95	2.092.253,17	2.12%
Hotele	14.856.951,18	1.405.079,09	9.46%

Por, sa realisht shifrat e dhëna nga institucionet referojnë ngrohjen e të gjithë ndërtesës institucionale apo vetëm të një pjese të saj? Për shembull: Nëse ~50% e institucioneve të edukimit publik përdorin energjinë elektrike për ngrohjen e ambientit, vlen kjo shifër për të gjithë ndërtesën e institucionit apo vetëm për ambientet e personelit si zyra, dhomë mësuesi etj.? Ky informacion nuk është mundur të identifikohet qartë gjatë intervistave tona ndaj e konsiderojmë si një kufizim të këtij vlerësimi. Nëse dyshimet se ato i referohen vetëm një pjese së të gjithë ndërtesës janë të vërteta, atëherë lind pyetja: *Sa do të ndryshojë kostoja e përdorimit të energjisë elektrike për shërbimet bazë të sigurimit të kushteve në punë? A do të mbetet ajo po në nivele të ulëta të ngjashme me 1% të të ardhurave mestare vjetore?*

Ndërkohë 71% e të intervistuarve shprehen se nuk kanë vështirësi në pagesën e faturës së energjisë elektrike, një shifër kjo që pritej më e lartë duke konsideruar % e ulët që zë fatura e energjisë elektrike në buxhetin vjetor. Por kjo shpjegohet duke vlerësuar buxhetet e ulëta që kanë institucionet publike për të kryer funksionet e tyre, dhe 1% e buxhetit për energji elektrike sërish mund t'i rëndojë institucionit. Vetëm hotelet kanë një përqindje më të lartë se kategoritë e tjera të vlerësuara ku ~10% prej tyre shprehen se kanë vështirësi në pagesën e faturës së energjisë elektrike.

Për 54% të ndërtesave të vlerësuara, të intervistuarit tregojnë se përdorin më pak energji elektrike sesa kanë nevojë për sigurimin e shërbimeve bazë të kushteve në punë, dhe kryejnë veprime kursimi si: Reduktimi i ngrohjes; Fikja e dritave; Ngrohja dhe përdorimi vetëm i ambientit ku punohet në institucion. Kategoria e institucioneve të cilët marrin



masa më të dukshme për reduktimin e kostos së energjisë elektrike janë Institucionet e edukimit publik (63%), ndjekur nga Administrata publike (62%) (Figura 30) të cilat kanë përqindjen më të ulët të buxhetit që kalon për faturën e energjisë elektrike.




Figura 30: Përqindja e sjelljeve të ndërmarra për të konsumuar më pak energji sesa nevojitet, sipas kategorisë së institucioneve

Ligji që adreson qartazi nevojën dhe standardet e ndërtesave për të rritur performancën e tyre të energjisë u miratua në 2016 dhe është ligji për performancën e energjisë së ndërtesave. Në këtë kuadër të gjithë të intervistuarit u pyetën nëse kishin dëgjuar për të dhe ~80% e tyre u përgjigjën **JO**.



INTERFERENCA

Në këtë hapësirë prezantohen gjetje të tjera të grupit të punës, jo të lidhura drejtpërdrejt me qëllimin dhe kategoritë e informacionit të pyetësorit, por të perceptuara nga vëzhgimet dhe bashkëbisedimet më të gjera me intervistuesit:

Gjatë vizitave në terren për plotësimin e pyetësorëve përveç përcjelljes së informacioneve ndërgjegjësuere për efikasitetin e energjisë, janë bërë edhe biseda me qytetarët e intervistuar për jetën e tyre të përditshme. Në pjesën më të madhe të familjeve, kryesisht në qytetin e Tiranës është parë se ka pakënaqësi për koston e faturës së energjisë elektrike në familje i cili konsiderohet i lartë duke patur parasysh konsumin e energjisë elektrike. Të shumta ishin veprimet që merreshin për të kursyer elektricitetin. Ajo që është vënë re, në nivel më të lartë ndër të moshuarit është mbajtja fikur e ngrohjes gjatë muajve të dimrit edhe kur ata do të dëshironin të ishte ndezur. Kjo në pjesë të madhe zëvendësohej me përdorimin e batanijeve dhe shisheve me ujë të ngrohtë. Megjithatë këto masa të lidhura kryesisht me ngrohjen merren për të kursyer, nga vlerësimi rezultoi se ngrohja e ujit ka ndikim të rëndësishëm në faturën e energjisë elektrike.

Nga vizitat në familjet vulnerabël është parë se kushtet e jetesës së disa prej tyre ishin në skajin e së pranueshmes. Në disa raste xhamat në dritare mungonin plotësisht duke u zëvendësuar me dërrasa, kartona apo qese. Në pjesën më të madhe të banesave myku ishte i dukshëm në mure. Dhoma ndriçohej nga një llambë e cila lidhej në tavan me dy fije elektrike të veshura vetëm me një shtresë ngjitës. Kjo paraqet rrezik jo vetëm për familjarët që banojnë aty, por edhe për të gjithë bllokun e banimit pasi mund të jetë shkak për zjarre në ndërtesë.

Gjatë bisedave që janë zhvilluar me familjarët, janë ngritur disa problematika lidhur me gjendjen e tyre shëndetësore. Në njërin prej familjeve vulnerabël, zonja e shtëpisë, mamaja e tre fëmijëve nuk arrinte të përfitonte shërbimet shëndetësore falas pasi nuk arrinte të pajisej me kartën e shëndetit. E regjistruar si pjesë e familjeve në nevojë, kur paraqitej në qendrën shëndetësore të lagjes për të bërë kërkesën e pajisjes me kartë shëndeti, e dërgonin nga njëra zyrë në tjetrën duke mos i dhënë zgjidhje. Në kohën kur është kryer vlerësimi, kjo situatë zgjaste prej rreth 8 muajsh. E pyetur për gjendjen e shëndetit të saj, ajo nuk dinte të jepte një përgjigje. Ajo u shpreh se nuk ndihej mirë, por nuk e dinte çfarë kishte duke mos patur mundësi të bënte kontrollin shëndetësor falas, si dhe nuk mund të përballonte ekonomikisht një kontroll me pagesë.

Situata me të cilën u ndeshëm në njërin prej familjeve në nevojë ishte tepër e vështirë. Kjo familje kishte 7 vite pa energji elektrike në banesë. Ngrohja, gatimi në këtë shtëpi bëhej me gaz dhe ndriçimi me qiri. Mund të kuptohet se sa jashtë realitetit të kësaj familje ishte studimi për përdorimin efikas të energjisë. Nga biseda me kryefamiljaren ajo kishte kërkuar shumë herë pranë zyrave përgjegjëse të pajisej me matës të energjisë elektrike. Përgjigjja që i jepej ishte se do të merreshin masa për këtë, por deri në atë kohë problemi i saj nuk kishte marrë asnjë zgjidhje.



Gjatë intervistave u vu re edhe se familjeve nuk është se i mungonte njohuria apo informacionin mbi efikasitetin e energjisë si dhe përfitimet ekonomike që që vinin nga përdorimi i llampave LED (llampave me diodë elektroluminishente). Ekzistonin familje ku fatura e energjisë elektrike vinte ende aforfe, si vijim kostoja e faturës së energjisë elektrike nuk tregon realisht konsumin e energjisë elektrike të këtyre familjeve. Në lidhje me konsumin e druve të cilët përdoren për ngrohje, por dhe për gatim etj. Nga perceptimet e anketuesve vlerat si për sasinë e drurit që konsumohet dhe shuma që paguhej për dru nuk tregonin realitetin duke supozuar se ka mjaft paligjshmëri në konsumin e druve. Pavarësiht vështirësive ekonomike apo ankesave për faturën e energjisë elektrike në përqindje të rritur të anketuarit shpreheshin për detyrimin e pagesës mujore të energjisë elektrike si një domosdoshmëri, ku mund të kursenin në aktivitete të tjera jetësore, vetëm që në fund të muajit të paguanin faturën e energjisë elektrike.

Sigurimi i furnizimit të ujit përbënte një shqetësim, në shumë familje nuk kishte furnizim uji, dhe mjaft të tjera e siguronin atë nëpërmjet puseve të ujit, atëherë dhe fatura e kostos së ujit nuk paraqiste realisht konsumin apo koston e faturës së ujit.

Përsa i përket kategorisë së institucioneve, kjo vërejtur kryesisht në qytetin e Tiranës mund të themi se gjendja e punonjësve është më e mirë krahasuar me përjetimin e familjarëve. E megjithatë, gjatë vizitave në qendrat shëndetësore dhe bisedës me punonjësit, dukej qartë pakënaqësia për lagështinë e ajrit dhe mungesën e ajrit. Kjo mund të lidhet me faktin se ndërtesat që ofrojnë këto shërbime janë mjaft të vjetra dhe nuk është bërë shumë për rikonstruktimin e tyre. Nëse merret parasysh se ata punonjës kalojnë të paktën 40 orë në javë në këtë ambient, mund të kuptohet ndikimi negativ që ka në shëndetin e tyre.



Figura 31. Myk i dukshëm në mur, “Kopshti nr. 35”, Tiranë

Në institucionet e edukimit publik, gjendja e ndërimit prej kopshteve ishte mjaft e papërshtatshme. Çerdhja nr. 35 ishte rikonstruktuar vitet e fundit. Megjithatë ky rikonstruksion ishte vetëm sipërfaqësor, gjë e cila ngrihej si problematikë nga punonjësit. Në kohën kur është kryer intervista muret kishin filluar të pësonin çarje për shkak të lagështisë së lartë (figura 31). Kjo ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e ajrit, si dhe në shëndetin e punonjësve dhe të fëmijëve që kalojnë një pjesë të madhe të ditës aty.

NJËSI EKONOMIKE FAMILJARE

Tipologjia e banesës

- Banesat në ndërtesat e reja, të ndërtuara kryesisht 5 vitet e fundit apo dhe ato pas viteve 1990, paraqiten banesat me kushte me të mira lidhur me izolimin e banesës, praninë e xhamave dopio, mungesës së problemeve me mykun dhe përputhshmërisë së dritareve dhe dyerve që pengojnë kalimin e rrymave të ajrit.

Ndërkohë banesat e vjetra kryesisht më shumë se 60 vjeçare, por dhe ato të ndërtuara pas viteve 1957 janë banesat të cilat shfaqen më problematike në lidhje me tiparet e mësipërme. Në këto banesa familjarët kanë dhe rritje të perceptimit të ajrit si shumë të lagësht dhe që temperatura në ambientin e brendshëm është shumë e ftohtë.

Përdorimi i energjisë elektrike

- Energjia elektrike përdoret gjerësisht për ngrohje e ujit duke patur dhe përdorimin më të madh për këtë domosdomëshmëri jetësore. Energjia elektrike përdoret më shumë për ngrohje sesa për ftohje megjithatë nuk vihet re një diferencë e ndjeshme midis dy përdorimeve.

Energjia diellore edhe pse në përdorim të ulët është e përdorur nga familjet kryesisht për ngrohjen e ujit si një alternativë me leverdi dhe miqësore me mjedisin.

Vlerësimi është zhvilluar në zonat urbane megjithatë vihet re se përdorim i biomasës është i pranishëm për ngrohje në masën 12%.

Përdorimi i energjisë elektrike për pompimin e ujit është në vlerën ~71% (e krahasueshme më përdorimin e energjisë për ngrohjen e ambientit (~75%) duke treguar që faturës së energjisë i shtohet dhe kostoja për sigurimin e furzinimit me ujë.

Kostoja e energjisë elektrike

- Familjet me të ardhura mujore më të larta kanë kosto mesatare mujore të energjisë elektrike më të lartë në krahasim me familjet me të ardhura mujore më të ulta. Ndërkohë që fatura e energjisë elektrike ka peshë më të madhe te familjet me të ardhura të ulta. Familjet me të ardhura mesatare mujore nën 10 000 lekë, jo më pak se 36% e të ardhurave shkon për faturën e energjisë elektrike dhe për familjet me të ardhura mesatare mujore mbi 50 000 lekë jo më shumë se 12% e të ardhurave shkon për faturën e energjisë elektrike.
- Më shumë se gjysma e të gjitha familjeve të intervistuar kanë vështirësi në pagesën e faturës së energjisë elektrike, vështirësi e cila është shumë e lartë te familjet me të ardhura mujore nën 10 000 lekë. Kjo vështirësi vazhdon të jetë e lartë (~90-80%) dhe te familjet me të ardhura mesatare mujore nën 50 000 lekë.
- Pavarësisht të ardhurave mesatare mujore 72% e të gjitha familjeve ndërmarrin veprime për të zvogëluar faturën e energjisë elektrike. Këto veprime janë në nivelin më të lartë te familjet me të ardhura mesatare mujore më të ulta sesa te familjet me të ardhura mesatare mujore më të larta.
- Familjet me të ardhura më të ulta kanë nivelin më të lartë të perceptimit të jetës së tyre si jo të lumtur. Familjet me të ardhura mesatare mujore mbi 50 000 lekë kanë nivelin më të lartë të perceptimit të jetës si të lumtur. Megjithatë në përgjithësi kampioni ka përqindje të lartë (51%) të vlerësimit të jetës, as të lumtur as të palumtur dhe 42% si të lumtur.



NJËSI TË TJERA

Tipologjia e ndërtesës

- Institucionet e shëndetit publik janë njësi me izolimin e plotë më të ulët, por ndërkohë paraqiten njësi me izolimin më të mirë pasi të gjitha institucionet e shëndetit publik të vlerësuara kanë izolim.
Ndërtesat e Administratës publike kanë nivelin më të lartë të mungesës së izolimit, duke mos patur diferencë shumë të ndjeshme me institucionet e edukimit publik.
Ndërtesat e administratës publike të ndërtuara ndërmjet viteve 1982-1991 kanë përqindjen më të lartë të mungesës së izolimit.
Institucionet e shëndetit publik të ndërtuara ndërmjet viteve 1957-1982 kanë mungesë totale të izolimit të plotë.
Institucionet e edukimit publik të ndërtuara 5 vitet e fundit kanë përqindjen më të lartë të mungesës së izolimit në krahasim me vitet e tjera të vlerësuara.
- Mbizotërojnë xhamat tek te të gjitha njësitë e vlerësuara dhe kornizat prej alumini. Ndërkohë që rrymat e ajrit që kalojnë në dyer dhe dritare janë kryesisht të pranishme në institucionet e shëndetit publik.
- Ndër njësitë e vlerësuara institucionet e edukimit publik janë më problematike në lidhje me praninë e mykut në godinë, njësi të cilat janë të ndërtuara kryesisht në vitet 1957-1982. Institucionet e edukimit publik më problematike për praninë e mykut janë ato të ndërtuara kryesisht pas viteve 1991 ndërkohë që, të gjitha ndërtesat e shëndetit publik të ndërtuara më shumë se 60 vite më parë kanë probleme me mykun. Ndërtesat e administratës publike të ndërtuara para viteve 1991 kanë të gjitha të njëjtat probleme me mykun.
Institucionet e edukimit publik janë njësi të cilat më shumë se tre njësitë e tjera të vlerësuara e perceptojnë temperaturën në ambientin e punës si shumë të ftohtë dhe ajrin shumë të lagësht.
- Hotelet paraqiten si njësi në nivelet më të mira në lidhje me karakteristikat e mësipërme.

Përdorimi i energjisë elektrike

- Energjia elektrike ka përdorimin më të madh për ngrohjen e ambientit dhe për pompimin e ujit. Ndërkohë që ftohja e ambientit ka përqindjen më të ulët të përdorimit të energjisë elektrike. Institucionet e edukimit publik janë njësi me përqindjen më të ulët të përdorimit të energjisë elektrike për ftohje dhe ngrohje të ambientit në krahasim me njësitë e tjera të vlerësuara

Kostoja e energjisë elektrike

- Afërsisht 71% të institucioneve nuk kanë vështirësi në pagesën e faturës së energjisë elektrike, dhe kostoja e faturës së energjisë elektrike (përveç njësisë hotele) nuk zë një përqindje të ndjeshme në buxhetin vjetor të institucionit. Ndërkohë 54% kryejnë veprime për të zvogëluar koston e energjisë elektrike. Institucionet e edukimit public, të cilat kanë dhe buxhetin më të ulët nga institucionet publike, ndërmarrin në nivel më të lartë veprimet për të zvogëluar faturën. Institucionet ndërmarrin më pak veprime për të zvogëluar konsumin e energjisë elektrike në krahasim me familjet.



- Në kushtet e përshkruara më sipër, në të cilat gjenden ndërtesat në vendin tonë pavarësisht shërbimeve që ofrojnë (familje, edukim, shëndet, etj.) vëmendje parësore duhet ti kushtohet rinovimit të tyre brenda standadeve të eficientë. Nxiten praktikat e mira të investimeve nga pushteti vendor, si dhe hartimi i politikave qendrore të rinovimit të ndërtesave aktuale. Është thelbësore për kushtet minimale të domosdoshme të një qytetari.
- Fushata të gjera dhe afatgjata informimi me banorët për eficientë e energjisë janë të rëndësishme për të patur një komunitet të ardhshëm që kupton eficienten dhe punon për ta zbatuar dhe ruajtur atë.
- Duhet përmirësuar politikat sociale të cilat ndihmojnë shtresat e familjeve me të ardhura të ulta për përballimin e nevojave bazë jetësore dhe të zhduken informalitetet.



SHTOJCA

1. **Informacion për organizatat e rrjetit të vigjilencës mjedisore**
2. **Fotografi nga vizitat në terren**
3. **Hartat e shpërdarjes së kampionit sipas koordinatave GPS për secilin qytet**

1. Informacion për organizatat e rrjetit të vigjilencës mjedisore

Qendra Mjedisore për Zhvillim Edukim dhe Rrjetëzim (Qendra EDEN) – organizata udhëheqëse e rrjetit

Adresa: Rr. "Bogdani" | Nd.13 | H.1 | Ap.8 |
Njësia bashkiake 10
Tiranë | Shqipëri
Web: www.eden-al.org
e-mail: eden@eden-al.org
Tel: 04 22 27 615
Fcb: Qendra EDEN/EDEN center



Qendra e Informacionit Aarhus – Shkodër (AIC Shkodër)

Adresa: Rr. 13 Dhjetori | Bashkia
Shkodër | Kati II | Shkodër | Shqipëri
Web: www.aic.org.al
e-mail: aicshkodra@gmail.com
Cel: 067 32 17 522
Fcb: "Qendra Aarhus Shkodër" dhe
"Mjedisi, të kontribuojmë së bashku
për Shkodrën"




Kulbi Ekologjik Elbasan – Elbasan (KEE)

Adresa: Lagjia A. Pasha | P 494/1 | H.2 | Nr.
15 | Elbasan | Shqipëri
Web: www.klubiekologjikel.org/
e-mail: ahmeteccel@hotmail.com
Tel: 054 258 698 Cel: 0692295889 Fcb:
Ahmet Mehmeti



Qendra për Kërkim Bashkëpunim dhe Zhvillim (CRCD) – Vlorë

Adresa: Lagjia Pavarësia | Rr. Pelivan
Leskaj | Kulla Xhaxho | Kati I | Vlorë | Shqipëri
Tel: 033 408708
Web: www.crcd.org.al
e-mail: info@crcd.org.al
Fcb: CRCD



Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore – Berat (PMSM-Berat)

Adresa: Lagjia 30 Vjetori | Rr. Sotir Kolea |
Pallati nr.5 | kati I | Berat | Shqipëri
Web: www.natyraberat.org/
e-mail: mireqeniesociale@gmail.com Tel:
068 40 94 694
Fcb: "For Social and Environmental
Welfare" Berat. @FSEW.BERAT



Qendra për Mbrojtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri (EcoAlbania)

Adresa: Rr. Kavajës | P. Qendra Tregtare
"GLOBE" | Ap. 11/3 | Tiranë | Shqipëri
Web: www.ecoalbania.org/sq/
E-mail: contact@ecoalbania.org
Tel: 04 43 17 720
Fcb: EcoAlbania



2. Fotografi nga vizitat në terren



Vendosja e llampave LED në një familje Tiranë



Mure jo efçente të një pallati Elbasan



Ambient i jashtëm i një qendre shëndetësore, Berat






**Vendosja e llampave LED në një familje në
nevojë Tiranë**



**Prania e mykut në ambientet e brendshme të
një familje në nevojë, Tiranë**



Mure jo efçiente të një pallati, Berat






Ambientet e brendshme të një institucioni, Vlorë



Përdorimi i gazit në ambientet e brendshme të një familje Tiranë



Ambientet e brendshme të një institucioni Vlorë



Ambient i brendshëm i një shkolle, Shkodër





Ambientet i jashtëm i një banesë, Tiranë



Ambjent i brendshme i një familje në nevojë (mungesa e dyerve, mure jo efçiente) ,Tiranë




Mure jo efçiente e një banese, Tiranë






Mure jo efçente e një banese, Shkodër



Ambientet e jashtëm e një kopshti, Shkodër



Vendojsa e llampave LED në familjet në nevojë, Tiranë



Plotësimi i pyetësorëve në terren



**Mure jo efçente,
prania e mykut,
Shkodër**





Ambientet i jashtëm i një banesë, Elbasan





Prania e mykut në ambientet e brendshme të një shkolle, Shkodër




Mure jo efçiente e një banese, Elbasan




3. Hartat e shpërndarjes së kampionit sipas koordinatave GPS për secilin qytet




Harta e shpërndarjes- Elbasan





Harta e shpërndarjes- Berat




Harta e shpërndarjes- Vlorë









Rr. Bogdanëve, Nd.13, H.1, Ap.8 , Njësia administrative 10, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri



+355 4 222 76 15



eden@eden-al.org



Qendra EDEN/ EDEN Center

